



FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

DIGOKSINE

Tableta – 0.25 mg
(*Digoksinë*)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

- Çfarë është Digoksine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Digoksine
- Si ta merrni Digoksine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Digoksine
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË DIGOKSINE DHE PËRSE PËRDORET

Digoksina është një glikozid kardiak digitalik që përdoret në menaxhimin e aritmisë supraventrikulare, dhe veçanërisht në fibrilacionin atrial dhe në insuficiencë kardiake. Veprimi kryesor i digoksinës është rritja e forcës kontraktuese të muskullit të zemrës dhe gjithashtu reduktimi i përqeshmërisë së zemrës, sidomos përcimi nëpërmjet nyjes atrioventrikulare. Digoksina gjithashtu zotëron një veprim të drejtpërdrejtë në muskujt e lëmuar të enëve të gjakut dhe njëkohësisht veprim jo të drejtpërdrejtë që fillon në sistemin nervor autonom dhe veçanërisht nga një rritje në aktivitetin vagal. Vihen re gjithashtu alteracione të refleksëve të aktivitetit autonom që varen nga efektet mbi sistemin cirkulator. Mbi të gjitha, këto efekte rezultojnë në efekte inotrope pozitive, efekte kronotrope negative, dhe ulje të aktivitetit të nyjes atrioventrikulare.

Si përfundim, mund të thuhet që efektet e dobishme të digoksinës janë rezultat i veprimtarive të drejtpërdrejta mbi muskulin e zemrës, si edhe i veprimit të tërthortë mbi sistemin kardiovaskular si rezultat i efekteve në sistemin nervor autonom.

Indikohet në:

- aritmitë supraventrikulare,
- insuficiencë kardiake.

2. PËRPARA SE TË MERRNI DIGOKSINE

Mos merrni Digoksine në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj digoksinës, glikozideve të tjerë digitalikë ose ndaj lëndëve ndihmëse të këtij bari;
- vuani nga takikardi ventrikulare ose fibrilacion ventrikular;
- vuani nga aritmi supraventrikulare të shkaktuara nga sindroma *Wolff-Parkinson-White*;
- vuani nga aritmi të shkaktuara nga intoksikimi me glikozide kardiake;
- keni bllok të plotë kardiak ose bllok kardiak të shkallës së dytë, veçanërisht në qoftë se pacienti ka pësuar ndonjëherë atak *Stokes-Adams*;
- keni kardiomiopati hipertrofike obstruktive.

Injeksionet e kripërave të kalçiumit kundërinduken gjatë mjekimit me digoksinë sepse mund të shkaktojnë aritmi serioze. Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna. Nëse shkoni tek ndonjë mjek tjetër apo dentist, njoftojeni që jeni duke marrë Digoksine.

Tregoni kujdes të veçantë me Digoksine

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- vuani nga dëmtim i funksionit të mëlçisë ose të veshkave;
- sapo keni kaluar infarkt miokardi;
- vuani nga hipotiroidizmi;
- keni sëmundje të rëndë respiratore;
- keni sindromën e sinusit të sëmurë;
- jeni duke përdorur kortikosteroidë, sepse ata nuk duhen përdorur gjatë mjekimit me Digoksine sepse mund të shkaktojnë hipokalemi.

Gjatë mjekimit duhen kontrolluar elektrolitet në serum dhe funksioni i veshkave.

Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Informoni mjekun tuaj në qoftë se jeni duke marrë ndonjë prej këtyre barnave:

- alprazolam, amiodaron, antikolinergjikë, benzodiazepina, ciklosporinë, diltiazem, difenoksilat, eritromicin, esmolol, felodipinë, flekainid, hidroksiklorokinë, ibuprofen, indometacinë, itrakonazol, kaptopril, nifedipinë, omeprazol, propafenon, propantelinë, kinidinë, kininë, tetraciklinë, tolbutamid dhe verapamil; këto barna mund t'i rrisin nivelet e digoksinës në serum, duke rritur efektet e saj terapeutike e helmuese;
 - aminoglutetimid, aminoglikozide (që merren nga goja), kolestiraminë, kolestipol, metoklopramid, neomicin, penicilinë, rifampicinë, sukralfat, dhe sulfasalazinë, sepse mund të ulin përthithjen gastrointestinale të digoksinës dhe të glikozideve digitalike, duke ulur nivelet në serum dhe efektet terapeutike;
 - barna të tjera që mund të ndërveprojnë me glikozidet kardiake si: albuterol, amfotericinë B, beta-blokuues, diuretikë të ansës, disopiramid, kripëra të kalçiumit, miorelaksues jodepolarizues, diuretikë që mbajnë kaliumin, suksinilkolinë, simpatomimetikë, diuretikë tiazidikë, tioaminë dhe hormone të tiroides.
- Këto barna mund të ndikohen nga digoksina, ose mund të ndikojnë në mënyrën se si vepron. Mund të keni nevojë të përdorni doza të ndryshme të këtij bari ose të merrni barna të tjera. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

Marrja e Digoksine me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Përdorimi i Digoksine gjatë shtatzënisë nuk është i kundërlinduar. Megjithatë, këshillohet të përdoret pasi të ballafaqohen përfitimet terapeutike për nënën me rreziqet e mundshme për fetusin.

Ushqyerja me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri. Digoksine nuk është e kundërlinduar edhe gjatë ushqyerjes me gji. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së saj në qoftë se jeni duke ushqyer foshnjën me gji apo keni në plan ta bëni këtë.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive. Pacientët që marrin Digoksine mund të shfaqin probleme me shikimin dhe me sistemin nervor qendror dhe këta pacientë duhet të jenë të vetëdijshëm për këto efekte të barit përpara se të drejtojnë automjetin apo përdorin makineri të tjera.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga lëndët ndihmëse të Digoksine

Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI DIGOKSINE

Ju lutemi të ndiqni këshillat e mjekut për mënyrën e marrjes dhe dozimin e Digoksine. Tabletat të merren me ushqim, me një gotë ujë. Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë. Dozat e këtij preparati për çdo pacient duhet të përcaktohen individualisht duke marrë parasysh moshën, peshën trupore dhe funksionin renal të pacientit. Duhet të theksohet që dozat e rekomanduara janë vetëm për fillimin e mjekimit me digitalik.

Dozat për pacientët me insuficiencë kronike të zemrës dhe mungesë të aritmisë supraventrikulare

Në këtë rast nuk kërkohet dozë sulmi. Zakonisht doza ditore është 0.125 mg deri në 0.25 mg për pacientët me funksion normal renal. Ndërsa për të moshuarit doza ditore është 0.0625 mg.

Dozat për menaxhimin e fibrilacionit atrial ose të rrahjeve të shpeshta të zemrës në të rriturit dhe fëmijët mbi 10 vjeç

Dozë sulmi e shpejtë:

Kur është e nevojshme dhe kërkohet një digitalizim i shpejtë doza që përdoret është:
0.75 deri në 1.5 mg si një dozë e vetme.
Në ato raste kur digitalizimi që kërkohet nuk është shumë urgjent ose është më e madhe mundësia e toksicitetit, si për shembull tek të moshuarit, doza orale e sulmit duhet të jepet në doza të ndara çdo 6 orë prej njëra-tjetrës, në mënyrë që të merret një përgjigje klinike para se të merret doza tjetër pasardhëse.

Dozë sulmi e ngadalhtë:
Digitalizimi mund të arrihet edhe më ngadalë me anë të dozave 0.25 deri në 0.75 mg, dozë e cila jepet një herë në ditë për një javë, e ndjekur më pas nga një dozë e caktuar mbajtëse. Përgjigjja klinike vihet re që në javën e parë të mjekimit. **Kujdes!** Zgjedhja midis dozës së shpejtë dhe të ngadalhtë të sulmit varet nga gjendja klinike e pacientit dhe nga fakti se sa urgjente është nevoja e tij për mjekimin.

Doza mbajtëse:

Zakonisht doza mbajtëse e digoksinës është 0.125 mg deri në 0.25 mg në ditë, por mund të variojë nga 0.0625 në 0.5 mg në ditë. Në pacientët e moshuar terapia duhet të fillojë ngadalë dhe me doza më të vogla.

Dozat për fëmijët

Dozat për fëmijët janë komplekse dhe bazohen në peshën trupore dhe statet e zhvillimit ku ndodhet fëmija si dhe në përgjigjen që ka fëmija ndaj terapisë me digitalik.

Përdorimi tek të moshuarit

Për përdorimin e digoksinës tek të moshuarit duhet patur parasysh funksioni renal i tyre dhe dobësia trupore sepse këta janë faktorë të cilët ndikojnë në farmakokinetikën e digoksinës. Megjithatë, mjeku juaj mund t'ju këshillojë të merrni një dozë tjetër në varësi të gjendjes tuaj dhe reagimit ndaj barit. Këshillohuni me mjekun tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt për përdorimin e këtij bari.

Në qoftë se keni marrë më shumë Digoksine

Në qoftë se keni marrë më shumë Digoksine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Digoksine

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:
• efekte anësore kardiovaskulare si: aritmi (aritmitë supraventrikulare janë më të zakonshme në foshnjat dhe fëmijët), përfshirë takikardinë ventrikulare të parakohshme;
• efekte në sistemin nervor qendror, si: dhimbje koke, dobësi, apati, përgjumje, depresion mendor, konfuzion, çorientim, psikoza.

Janë konstatuar edhe anoreksi, nauze, të vjella, diarre, eozinofili, reaksione në lëkurë, çrregullime gastrointestinale, gjinekomasti, trombocitopeni dhe çrregullime të të parit.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI DIGOKSINE

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Digoksine pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Digoksine
Lënda aktive është digoksina.
Çdo tabletë përmban 0.25 mg digoksinë.
Lëndët ndihmëse janë: laktozë monohidrat, amidon, celulozë mikrokristalore, povidon, stearat magnez.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtimit dhe Prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +3554 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

